



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 55 , Datë 30.03.2011

Ndryshuar me vendim Bordi nr. 123 datë 25.11.2013

Ndryshuar me vendim Bordi nr. 132 datë 26.11.2015

PËR

**NJOHJEN E VEPRIMTARISË SË AGJENTIT TË BROKERIT TË LICENCUAR TË
LETRAVE ME VLERË**

Në bazë dhe për zbatim të kërkesave të pikës 23 të nenit 14 të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” të pikës 10, të nenit 42 të Ligjit Nr.9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOISE:

Ligji Nr.9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt” në pikën 10, të nenit 42, i jep të drejtën Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të njohë veprimtarinë e agjentit të brokerit të letrave me vlerë, si veprimtari e lidhur me transaksionet me titujt (letrat me vlerë).

Direktiva 2004/39/EC (MiFID) njih veprimtarinë e agjentit të brokerit dhe në nenin 4.1.25 e përcakton agjentin si më poshtë:

“Agjent i lidhur, do të thotë një person fizik apo juridik i cili, nën përgjegjësinë e plotë dhe të pakushtëzuar të vetëm të një shoqërie brokerimi në emër të të cilit ai vepron, nxit investimet dhe / ose shërbimet ndihmëse për klientët ose klientët e mundshëm, pranon dhe transmeton udhëzime ose urdhra nga klienti në lidhje me shërbimet për investime ose instrumentet financiare dhe / ose jep këshilla për klientët ose klientët e mundshëm në lidhje me ato instrumenta financiare apo shërbimeve”;

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është nënshkruar me të drejta të plota të Marrëveshjes Multilaterale me Autoritetet e tjera, anëtare të IOSCO-s, “Për shkëmbimin e informacionit”,

Interesimi i disa subjekteve: shoqëri, banka apo individë, të cilët mund të luajnë rolin e agjentit për një broker të licencuar, i cili (ky i fundit) operon në një vend jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në fushën e letrave me vlerë.

Për sa më sipër ,

V E N D O S I

1. Të njohë “veprimtarinë e agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë”, si veprimtari e lidhur me transaksionet me titujt (letrat me vlerë).
“Veprimtaria e agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë konsiston në:
 - a. promovimin e veprimtarisë së brokerit;
 - b. marrjen dhe transmetimin e urdhrave apo udhëzimeve nga klientët/klientët e mundshëm;
 - c. ofrimin e këshillave për klientët ose klientët e mundshëm në lidhje me titujt dhe instrumentet financiare”.
2. Agjenti do të veprojë në emër dhe për llogari vetëm të një brokeri të licencuar të letrave me vlerë në territorin e Republikës së Shqipërisë, apo të një brokeri të licencuar nga Autoritetet e tjera mbikëqyrëse, anëtare të IOSCO-s, nënshkruese të MMOU.
3. “Veprimtaria e agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë do të kryhet vetëm nga shoqëritë komisionere ose bankat të licencuara nga Autoriteti në përputhje me nenin 49 të Ligjit Nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt””.
4. “Autoriteti shqyrton kërkesën për kryerjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar, vetëm pasi subjekti, i cili plotëson kërkesat e pikës 3 të këtij vendimi, ka depozituar në Autoritet:
 - a) kërkesën për të marrë miratimin për të kryer veprimtarinë e agjentit të brokerit të licencuar;
 - b) kontratën e agjentit me brokerin e letrave me vlerë, në emër dhe për llogari të të cilit do të veprojë;
 - c) licencën e brokerit të letrave me vlerë, në emër dhe për llogari të të cilit do të veprojë, lëshuar nga Autoriteti përkatës;
 - d) rregullat e brendshme që rregullojnë marrëdhëniet me klientin për këtë veprimtari”.
5. “Shoqëria që kryen veprimtarinë e agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë duhet të respektojë kërkesat e Ligjit Nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”

5/1. Agjenti i brokerit të licencuar të letrave me vlerë në njoftimet publike apo reklamata e publikuara në mjetet e komunikimit në masë dhe në mjetet e komunikimit elektronik duhet të deklarojë dukshëm rrezikun që mbart tregtimi në platformën online. Teksti i njoftimeve publike apo të reklamave në lidhje me rrezikun përpara se të publikohen, depozitohen në Autoritet. Nëse Autoriteti brenda tre ditëve pune nga paraqitja e tekstit të njoftimit apo reklamës nuk e ndalon zyrtarisht publikimin, agjenti e publikon atë.”

- 6. “Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë, shoqëria detyrohet të paguajë ndaj Autoritetit shumën prej 10.000 lekë”.*
- 7. “Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve komunikon me aplikantin për agjent mbi plotësimin e kriterëve të këtij vendimi”.*
- 8. “Shoqëria që kryen veprimtarinë e agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë raporton çdo 3-muaj në AMF mbi veprimtarinë e kryer, sipas formatit bashkëngjitur këtij Vendimi”.*
- 9. Mosrespektimi i kërkesave të këtij vendimi, shoqërohet me sanksionet përkatëse, referuar Ligjit Nr.9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”.*
- 10. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE****Adresa: Rruga "Dora D'istria" Nr. 10,****P.O.Box 8363, Tiranë, Albania,****Tel: + 355 - (0) - 4 - 2251355/6,****Faks: + 355 - (0) - 4 - 2250686****FORMULAR RAPORTIMI****MBI****VEPRIMTARINË E AGJENTIT TË BROKERIT TË LICENCUAR TË LETRAVE
ME VLERË**

Emri i agjentit të miratuar.....

NIPT i regjistrimit në QKR.....

Shoqëria e Brokerimit për të cilën punon.....

Periudha e raportimit

I. Të dhëna për investitorët

Nr. i investitorëve sipas kategorive	Në fillim të periudhës raportuese	Të rinj në periudhën raportuese	Të larguar në periudhën raportuese	Totali në fund të periudhës raportuese
Nr. i investitorëve individualë				
Nr. i investitorëve Institucional (institucione financiare)				
Nr. i investitorëve persona të tjerë juridikë				

II. Aktiviteti i kryer

	Në fillim të periudhës raportuese	Në periudhën raportuese	Tërheqjet në periudhën raportuese	Totali në fund të periudhës raportuese
Shuma e Depozituar				
Lekë				
EURO				
USD				
Të tjera				

	Në fillim të periudhës raportuese	Në periudhën raportuese	Totali në fund të periudhës raportuese
Shuma e Tregtuar			
Lekë			
EURO			
USD			
Të tjera			
Nr. i transaksioneve			
Lekë			
EURO			
USD			
Të tjera			

III. Të ardhurat nga komisionet

Të ardhurat e agjentit nga komisionet	Në fillim të periudhës raportuese	Në periudhën raportuese	Totali në fund të periudhës raportuese
Lekë			
EURO			
USD			
Të tjera			

Nënshkrimi i Personit të Autorizuar

Data e plotësimit _____

Shënime:

- 1. Ky formular plotësohet çdo 3-muaj. Agjenti i miratuar detyrohet që të dorëzojë në AMF formularin e plotësuar brenda datës 5 të muajit pasardhës, sipas periudhave respektive.*
- 2. Të dhënat progresive jepen për çdo vit kalendarik.*
- 3. Një transaksion nënkupton mbylljen e një pozicioni të hapur në platformë.*
- 4. Formulari plotësohet në excel.*